VENDIM
Nr. 197, datë 3.8.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 40, DATË 10.3.2022 "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'LAJTHIZA INVEST' SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC 'QAMI 1', ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 MW"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 144/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/3 prot., datë 26.7.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022 "Mbi licencimin e shoqërisë 'Lajthiza Invest' sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Qami 1', me kapacitet të instaluar 1.730 MW",

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 40, datë 10.3.2022, të ndryshuar dhe me vendimin nr. 102, datë 9.5.2022, Bordi i ERE-s vendosi të licencojë shoqërinë "Lajthiza Invest" sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me kusht që: 2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara të qirasë për gjithë territorin ku shtrihet projekti, përkatësisht me Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Bashkinë Kukës, ose çdo dokument tjetër që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet te këto dy bashki. ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr. 102/2022, me shkresën nr. 11/11 prot., datë 23.5.2022.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 11/12 prot., datë 22.7.2022, shoqëria ka bërë me dije ERE-n se ka aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) përkatëse për regjistrimin e kontratës që i jep të drejtën për të përdorur pronën në pjesën e territorit që projekti prek Bashkinë Kukës, më datë 15.4.2022.
- Si dhe në datën 7.7.2022, janë vënë në dispozicion të ZVRPP Kukës të gjitha dokumentet sipas kërkesës së saj.
- Në këto rrethana shoqëria është në pritje të përgjigjes nga ZVRPP-ja përkatëse.
- Për gjithë sa më sipër deklaruar e depozituar nga shoqëria, konstatohet se ka bërë aplikimet përkatëse brenda afatit 30-ditor të përcaktuar në vendim (afati i fundit data 7.7.2022).
- Për sa më sipër dhe duke qenë se shoqëria ka dokumentuar në ERE përpjekjet e saj dhe aplikimet përkatëse për t'u pajisur me dokumentacionin pronësor, vlerësohet që t'i lihet afat depozitimi i këtij dokumentacioni në ERE brenda 60 ditëve pune, afati i cili fillon nga data 7.7.2022.
- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: "Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit nr. 40, datë 10.3.2022, të Bordit të ERE-s ndryshon dhe bëhet:

"2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara të qirasë me Bashkinë Kukës, ose çdo dokument tjetër që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e

projektit që shtrihet te kjo bashki, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pune, duke filluar ky afat nga data 7.7.2022.".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti